



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TEPELENË
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr 1694.Prot

Tepelenë më, 29.07.2022

VENDIM

Nr.59. datë 28/07/2022

PËR

" KRIJIMIN E SHËRBIMIT VULLNETAR PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN NË BASHKINË TEPELENË "

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës , të nenit 8, pika 2, nenit 9,pika 1, nënpika 1.1, shkronja" b", nenit 29, pika 2,nenit 54, shkronja "k", nenit 55,pikat 2 dhe 6,te Ligjit nr.139/2015, "Për veteqeverisjen vendore",ë ndryshuar ,nenit 13,pika 2,të Ligjit nr.152/2015,"Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", Ligjin nr. 45/2019,"Për mbrojtjen civile",Ligjit nr.45/2016,"Për vullnetarizimin", me propozimin e Kryetarit të Bashkisë , Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e datës 28.07.2022

VENDOSI:

- 1.Krijimin e Shërbimit Vullnetar për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin në Bashkinë Tepelenë.
- 2.Shërbimi Vullnetar është pjesë e shërbimit të Sektorit së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi dhe ka një numër prej 21(njëzet e nje) vullnetarësh të ndarë në 4 njësi administrative.
- 3.Shërbimi vullnetar i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit ka si mision kryesor rritjen e angazhimit qytetar dhe dhënien e kontributit vullnetar për parandalimin dhe nderhyrjen për shuarjen e zjarreve ,shpëtimin e jetës , si dhe menaxhimin e fatkeqesive të tjera dhe zvogelimin e pasojave të tyre në territorin e Bashkisë Tepelenë.
- 4.Të miratoje strukturën e shërbimit vullnetar, sipas Aneksit nr.1, bashkëlidhur dhe pjesë përberese e këtij vendimi.

5. Shërbimi vullnetar drejtohet nga Komandanti i shërbimit vullnetar , i cili emërohet dhe shkarkohet nga Kryetari i Bashkisë dhe është përgjegjës për funksionimin dhe administrimin e këtij shërbimi.

6. Të miratojë uniformën dhe shënjat dalluese të vecanta të shërbimit vullnetar, sipas Aneksit nr. 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërese e këtij vendimi.

7. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i parashikuar për vitin 2022 për Emergjencat Civile pranë Bashkisë Tepelenë.

8. Të drejtat dhe detyrimet , kushtet dhe kriteret e nevojshme për kryerjen e aktiviteteve dhe shërbimeve vullnetare përcaktohen në kontratën e vullnetarizimit dhe lidhet midis Bashkisë Tepelenë dhe anëtareve të shërbimit vullnetar.

9. Në zbatim të pikës 7, të këtij vendimi, ngarkohet Kryetari i Bashkisë ose personi i autorizuar prej tij për lidhjen e kontratës me vullnetarët.

10. Një kopje të këtij vendimi ti njoftohet Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Drejtorisë së Përgjithshme të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

11. Ngarkohen Kryetari i Bashkisë , Drejtorja e Burimeve Njerëzore, Drejtorja e Financave, Sektori për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin, , Zyra e Mbrojtjes Civile, për zbatimin e këtij vendimi.

12. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore " të ndryshuar.

**KRYETAR
ELVIS SHEHU**

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Valbona ÇELA

Miratuar me 11 vota
Vota Pro 11 (njëmbëdhjetë)
Vota Kundër 0
Vota Abstenim 0
Zbardhur me datë 29.07.2022.